

11.02.2021
Ora 17:37

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 45, datë 04.02.2022 “Për caktimin e vendeve të numërimit të votave të ZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr. 54, nr. 55, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Mirëmbërëma! Atëherë në seancën e sotme publike janë për shqyrtim në rend të ditës 11 projektvendime. Projektvendimi për një ndryshim në vendimin nr. 45, datë 04.02.2022 “Për caktimin e vendit të numërimit të votave në ZAZ-të ku do të zhvillohet ky proces”. Projektvendimi “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, Durrës nga Partia Lëvizja e Re, Shkodër, nga Partia Socialiste, Lushnje nga Partia Socialiste, Durrës nga Partia Socialiste, Durrës nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, Bashkia Lushnje, kandidati i propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”. Pika e 8, projektvendimi “Për regjistrimin e kandidatit për Bashkinë e Shkodrës nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.

Pika 9, projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie Lushnje, të propozuar nga Partia Demokratike”.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Pika 10, projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie Shkodër, propozuar nga Partia Demokratike”, dhe pika e 11, projektvendimi që lidhet me regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, propozuar po nga Partia Demokratike. Mirë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaç: Zoti Komisioner! Përpara se të nisim, kam një propozim. Dua të shtyj pikën e dytë të rendit të ditës, për në fund të mbledhjes, pasi kemi një paqartësi me mandatin që zotëron në Këshillin Bashkiak Durrës, kandidati Jonid Robert Nano.

Z. I. Celibashi: Pika e dytë është për Bashkinë Durrës, kandidat i propozuar nga Partia Lëvizja e Re.

Pika e tretë është për kandidatin e propozuar nga Partia Socialiste në Shkodër, Majlinda Xhevdet Angoni.

Pika e katërt, për regjistrimin e kandidatit të Partisë Socialiste Lushnje.

Pika e pestë, për regjistrimin e kandidatit të Partisë Socialiste Durrës.

Pika e gjashtë, për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.


Pika e shtatë, propozimi për regjistrimin e kandidatit të koalicionit “Shtëpia e Lirisë” në Lushnje.

Pika e tetë, projektvendimi për regjistrimin e kandidatit të koalicionit “Shtëpia e Lirisë” në Shkodër.

Pika e nëntë. Projektvendimi për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnje, të propozuar nga Partia Demokratike.

Pika e dhjetë, projektvendimi për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Shkodër, propozuar nga Partia Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Pika 11. Propozimi i projektvendimit për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, propozuar nga Partia Demokratike.

Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Në fakt edhe unë për procedurë do doja që duke qenë se në listën e dokumentacionit që i janë bashkëlidhur kërkesës për regjistrimin e kandidatit zotit Jonid Nano, përmendet dhe një vërtetim i lëshuar nga kryetari i Këshillit Bashkiak Durrës. Do doja që të njiheshim me këtë dokument, në qoftë se është e mundur paraprakisht?

Z. I. Celibashi: Nëse kemi një kopje jua japim tani. Dhe propozimi është për ta shtyrë shqyrtimin e kësaj? Në rregull! Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, për projektevendimin “Për ndryshimin e vendimit nr. 45, datë 04.02.2022, për caktimin e vendit të numërimit të votave në ZAZ-të, 2, 3, 4, 5, 19, 21, 22, 23, 24, 26, 43, 54 dhe 55”.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr. 45, datë 04.02.2022 ka caktuar si vend numërimi të votave ndër të tjerët edhe për KZAZ-në nr. 5, palestrën e shkollës 9-vjeçare “Edit Durham”. Prefekti i Qarkut Shkodër në datën 06.02.2022 me arsyetimin e mbështetur dhe me kërkesën e paraqitur nga KZAZ-ja nr. 5 ka propozuar palestrën e shkollës “Xheladin Fishta” dhe ka parashtruar dhe arsyet pse e kërkon këtë ndryshim. Gjithashtu kjo palestër e shkollës ka shërbyer si VNV dhe në zgjedhjet e tjera, dhe plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93, 94 të Kodit Zgjedhor, pasi ZAZ-ja nr. 5 ka 47 qendra votimi dhe objekti ka një sipërfaqe 500m², kështu që plotëson kërkesat. Duke qenë se kërkesa vjen nga prefekti i Qarkut Shkodër, si dhe është mbështetur dhe nga

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

kërkesa e KZAZ-së nr.5, të cilët janë dakord për ta ndryshuar vendndodhjen e VNV-së të KZAZ-së nr. 5, nga shkolla “Edit Durham” tek shkolla “Xheladin Fishta”, po paraqesim kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së nr. 5. Bashkëlidhur keni projektvendimin dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Në fakt edhe ne jemi njohur me kërkesën e prefektit të Qarkut Shkodër për ndryshimin e VNV-së pranë shkollës 9-vjeçare “Xheladin Fishta”. Kemi pasur edhe një komunikim me anëtarët e KZAZ-së të propozuar nga ana e Partisë Demokratike, të cilët e kanë gjetur të drejtë këtë propozim, prandaj jemi dakord me bërjen e këtij ndryshimi, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë bëjmë ndryshimin e vendimit nr. 45, që lidhet me ndryshimin e vendndodhjes së VNS-së për Bashkinë Shkodër, KZAZ nr. 5, duke u transferuar nga palestra e shkollës 9-vjeçare “Edit Durham”, në palestrën e shkollës 9-vjeçare “Xheladin Fishta”.

Vendimi nr. 61

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



11.02.2021
Ora 17:44

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Shkodër të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, zonja Majlinda Xhevdet Angoni për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e tretë, se pikën e dytë e shtymë për ta shqyrtuar më vonë.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialiste regjistrohet si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka paraqitur kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e zonjës Majlinda Xhevdet Angoni, si kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës. Zonja Majlinda Xhevdet Angoni ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se në rubrikën e të dhënave personale, ka deklaruar se e ka ndryshuar mbiemrin nga Jubani në Angoni. Komisioni i Qendrës së Zgjedhjeve ka

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë i është përgjigjur vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, e cila ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për kryetar të Bashkisë Shkodër, zonjës Majlinda Angoni, e cila rezulton se nuk ka të regjistruara dënime penale të formës së prerë. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit, si dhe nga informacionet e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar të Bashkisë Shkodër, zonjën Majlinda Angoni, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Mirë, përfaqësues të partive? Nuk kemi! Mirë, faleminderit, atëherë vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, zonjën Majlinda Xhevdet Angoni, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 62

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 17:46

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Lushnje të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, zonja Eriselda Musa Sefa për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia Socialiste e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e zonjës Eriselda Musa Sefa, si kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnje. Bashkë me këtë kërkesë është depozituar dhe dokumentacioni përkatës. Zonja Eriselda Sefa, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi paraprak i formularit rezulton se nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje, vetëm Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

kandidatit, e cila rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit, si dhe informacionet e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Besoj nga partitë s'kemi ndonjë koment. Vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnje, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, zonjën Eriselda Musa Sefa, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 63

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 17:48

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, zj. Emiriana Hiqmet Sako për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)

• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Partia Socialiste e Shqipërisë e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e zonjës Emirjana Sako, si kandidate për kryetare të Bashkisë Durrës, si dhe ka depozituar dokumentacionin përkatës për këtë kandidate. Zonja Emirjana Sako ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi paraprak rezulton se nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë ka kthyer përgjigje vetëm Drejtoria e Përgjithshme e

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Gjendjes Gjyqësore, e cila ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit, e cila rezulton se nuk ka dënime penale të formës së prerë. Pra, rezulton e padënuar. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit si dhe informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga Partia Socialiste për kandidaten për kryetar të Bashkisë Durrës, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive? Nuk kemi diskutime! Atëherë, vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar në Bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, zonjën Emirjana Hiqmet Sako të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 64

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 17:49

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (Sh-L), z. Ardian Mihal Muka për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:** **PD (M.Logu)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e zotit Ardian Muka, si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës. Gjithashtu ka depozituar dhe dokumentacionin përkatës. Zoti Ardian Muka ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, dhe nga verifikimi paraprak i formularit, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

e gjendjes gjyqësore për kandidatin, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar të bashkisë të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive? Nuk kemi diskutime! Atëherë, vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar në Bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, zotin Ardian Mihal Muka, të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 65

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 17:54

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Lushnjë të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (Sh-L), z. Elton Ilir Bano për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

Z. Y. Merkaj: Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin e zotit Elton Ilir Bano, si kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnje. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës. Zoti Elton Ilir Bano ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se në rubrikën, të dhënat personale, ka deklaruar se ka ndryshuar datëlindjen nga 24.01.1981 në 24.07.1978 dhe vendlindja nga Prishtinë, Kosovë, në Lushnje. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka kthyer përgjigje, duke dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnje, i cili rezulton se nuk ka shënime në regjistrin penal, dhe rezulton i padënuar. Referuar ligjit 138/2015 të dhënat e personit të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar të Bashkisë Lushnje, zotit Elton Ilir Bano, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tij për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur projektvendimit keni dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive?


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Nga formulimi i vetëdeklarimit, ose i dekriminalizimit që ka dorëzuar zoti Bano, rezulton që ai ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?

Z. Y. Merkaj: Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka jetuar jashtë shtetit.

Z. I. Celibashi: Jo, në formularin e vetëdeklarimit ai nuk ka shënime që tregon që ka jetuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ka banuar, jo nuk ka!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, qartë! Sepse është pak, po themi kurioze, fakti që ka deklaruar vendlindjen në Prishtinë, Kosovë dhe më pas e ka ndryshuar në Lushnje. Më duket pak si e dhënë e çuditshme.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Znj. M. Koja: Konstatimi është ai i pasqyruar në relacion. Zoti Bano ka dy vendlindje të ndryshme dhe dy data lindjeje të ndryshme. Për të qartësuar situatën është kërkuar informacion pranë Zyrës së Gjendjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pra, ka ndryshuar dhe emrin, mbiemrin, po thoni?


Znj. M. Koja: Ka ndryshuar ditëlindjen dhe vendlindjen. Rezulton me dy vendlindje të ndryshme, dhe me dy data lindjeje të ndryshme nga njëra-tjetra.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po në këtë rast, nuk do ishte pak më e udhës që për rastin, të prisnim dhe përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile?

Znj. M. Koja: Ne procedojmë në këtë mënyrë. Nuk është një rast i parë. Sot që flasim, nuk kemi asnjë përgjigje nga Zyra e Gjendjes Civile për asnjë nga kandidatët që sot kalojnë në seancë. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje dhe rezulton i padënuar.

Z. I. Celibashi: Kjo është dhe praktika që ka ndjekur KQZ-ja sepse në këtë verifikimin *prima facia* që bëjmë ne, rezulton që nuk ka pengesë. Mundet të qëllojë që edhe pas një përgjigjeje përfundimtare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, të mos marrësh informacionin që mund ta penalizojë në kandidim dhe mbas një kohe të dytë për një rrethanë ose për një tjetër, në një verifikim më të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

thelluar, mund të rezultojë problem. Kështu që unë them të vazhdojmë me procedimin. Të procedojmë me regjistrimin dhe pastaj nëse është rasti...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo, duket, domethënë, unë e kuptoj kur dikush deklaron një datë të ndryshme që mund të jetë një lapsus, por kur deklaron vite të ndryshme për ditëlindjen dhe më pas deklaron shtete të ndryshme për vendlindjen, ky është rast pak, që mendoj që meriton vëmendje. Kur është një rast siç mund të jetë, ka lindur në Fiershegan, por në fakt ka lindur në qytetin e Lushnjes, që janë, po themi zona të përiferëta, kjo dhe mund të kuptohet që mund të jetë një lapsus, pasaktësi edhe e gjendjes civile. Por nga një shtet, në një shtet tjetër, se për efekt të asaj kemi të bëjmë me dy shtete të ndryshme, ku në këtë rast, po themi, që ndoshta meriton edhe të ndalemi dhe mbase është nga ato raste që mund edhe të pritej një përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithsesi në vlerësimin tuaj, por them që gjithsesi ndoshta dhe ky informacioni që ka Sekretari i Përgjithshëm.

Z. I. Celibashi: Jemi në të njëjtin argument që nga pikëpamja formale nuk është se ka ndonjë pengesë, fakti që ka korigjuar vendlindjen dhe ka korigjuar datëlindjen. Sikurse nga ana tjetër meritohet që të ketë një hetim më të thelluar në lidhje me këtë fakt. Por, për efekt edhe të kohës edhe për të ecur dhe me përgatitjet, sikurse e kemi patur dhe eksperiencën e rasteve të tilla të ngjashme me zgjedhjet e kaluara, procedojmë me regjistrimin si kandidat dhe pastaj vazhdojmë verifikimin. Ne do të presim përgjigjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, mund të ketë dhe rrethana të tjera, dokumente të tjera, të cilat na bëjnë që të kemi një investigim më të thelluar. Po, Sekretar!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Z. Y. Merkaj: Pasi bëmë verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit të kandidatit, pyetjes që bëri përfaqësuesi i Partisë Demokratike, a ka jetuar ndonjëherë jashtë shtetit, kandidati i është përgjigjur "Po". Ka jetuar jashtë shtetit, ka qenë në Bukuresht, në Rumani për arsye studimi. Ka qenë në Londër për emigracion. Ka qenë dhe në Romë, Itali, për arsye shëndetësore. Periudhat nëntor 1996-1997, korrik 1998-2000 dhe qershor 2020-2021.


Z. I. Celibashi: Po, këto janë rrethanat për të parë. Këtë situatë duhet ta zgjidhë ligji. Mirë vazhdojmë! Atëherë, vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnje, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, zotin Elton Ilir Bano të propozuar nga koalicioni "Shtëpia e Lirisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 66

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



**11.02.2021
Ora 17:51**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Shkodër të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (Sh-L), z. Bardh Ali Spahia për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta**
- **Parti Politike:** **PD (M.Logu)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës

Z. Y. Merkaj: Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” i regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e zotit Bardh Ali Spahia, si kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër. Gjithashtu ka depozituar dhe dokumentacionin përkatës. Zoti Bardh Spahia ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi rezulton se në rubrikën, të dhënat mbi gjendjen gjyqësore të personit, ka deklaruar se është dënuar. Është proceduar nga Prokuroria e Shkodrës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër, për vepër penale të parashikuar nga neni 242, 236/2 dhe 151 të Kodit Penal, për të cilën në datën 19.07.2020 është vendosur pushimi i procedimit penal. Gjithashtu ka deklaruar se

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022**

është caktuar ndaj tij masa arrest shtëpie dhe detyrim paraqitje në policinë gjyqësore, të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale, mosbindje të urdhrimit të policisë, për të cilën në datën 19.07.2020 dhe 09.11.2020 është vendosur pushimi i çështjes. Për pjesën tjetër nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138/2015. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, është përgjigjur vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, e cila ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit për kryetar të Bashkisë Shkodër, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë. Pra, figuron i padënuar. Referuar ligjit nr. 138/2015 e të dhënave të deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacionin e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, rezulton se nuk përbën kusht për mosregjistrimin e kandidatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Shkodër, të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive?


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderti zoti Celibashi! Një pyetje kisha në qoftë se është e qartë për administratën. Për cilën vepër penale është proceduar zoti Bardhi?

Z. Y. Merkaj: Mosbindje të urdhërit të policisë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Vetëm për mosbindje të urdhërit të policisë?

Zbardhi materialin audio

Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar për Bashkinë Shkodër, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, zotin Bardh Ali Spahia të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 67

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 18:00

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Lushnjë të propozuar nga Partia Demokratike, z. Indrit Shpëtim Sefa për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia Demokratike e regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin e zotit Indrit Shpëtim Sefa, si kandidat për kryetar të Bashkisë Lushnje. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dokumentacioni përkatës. Zoti Indrit Shpëtim Sefa ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi paraprak rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

e gjendjes gjyqësore të kandidatit për kryetar të Bashkisë Lushnje, i cili rezulton se nuk ka regjistruar dënime penale të formës së prerë. Pra, figuron i padënuar. Referuar ligjit 138/2015 të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacionet e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar të bashkisë të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë s'kemi besoj ndonjë diskutim në lidhje me këtë projektvendim? Vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar në Bashkinë Lushnje, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022, zotin Indrit Shpëtim Sefa të propozuar nga Partia Demokratike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 68

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 18:03

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër të propozuar nga Partia Demokratike, z. Xhemal Esat Bushati për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022".

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Partia Demokratike e regjistruar si subjekt zgjedhore për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin e zotit Xhemal Esat Bushati, si kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër, si dhe ka depozituar dhe dokumentacionin përkatës. Zoti Xhemal Esat Bushati ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i formularit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni Qendror së Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

gjyqësore për kandidatin për kryetar të Bashkisë Shkodër, zotin Xhemal Esat Bushati i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë, pra është i padënuar. Referuar ligjit nr. 138/2015 të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacionet e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar të Bashkisë Shkodër zotin Xhemal Esat Bushati, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tij për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive? Nuk kemi diskutim! Atëherë, vendosim regjistrimin si kandidat për kryetar të Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022, zotin Xhemal Esat Bushati të propozuar nga Partia Demokratike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 69

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



11.02.2021
Ora 18:05

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës të propozuar nga Partia Demokratike, z. Luan Haki Hoti për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y. Merkaj, M. Koja, E. Meta

• **Parti Politike:**

PD (M.Logu)


• **OJQ:**

KRIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me Durrësin.

Z. Y. Merkaj: Partia Demokratike e regjistruar si subjekt zgjedhore për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrimin e zotit Luan Haki Hoti, si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës. Zoti Luan Haki Hoti ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku nga verifikimi paraprak ka rezultuar se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr. 138 të vitit 2015. Komisioni i Qendror së Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar verifikimin e

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

gjendjes gjyqësore të kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Luan Hoti, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë. Referuar ligjit të dekriminalizimit, të dhënat e deklaruara në formularët e vetëdeklarimit dhe informacionet e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar të Bashkisë Durrës, zotin Luan Haki Hoti, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tij për zgjedhjet e pjesshme vendore, për kryetar të bashkisë të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive, s'kemi! Edhe në këtë rast nuk e kanë sjellë përgjigjen ata të gjendjes civile apo jo? Megjithatë vazhdojmë. Vendosim të regjistrojmë si kandidat për kryetar në Bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022, zotin Luan Haki Hoti të propozuar nga Partia Demokratike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Mirë i përfunduar. Atë e shtymë, shqyrtimin e...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dëgjoni, zoti Komisioner, për zotin Luan Hoti nuk ka ndonjë element në formularin e vetëdeklarimit që të na bëjë të ndalemi. Nga verifikimi i parë nuk ka dalë ndonjë gjë që na bën të kuriozohemi.

Z. I. Celibashi: Në çdo rast fakti që mund të ketë disa ndryshime në gjeneralitetet e personit, jo *by default* e bën atë, e skualifikon atë nga regjistrimi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Absolutisht! Veçse duhet pasur parasysh, po themi edhe nga praktika e mëparshme që ka pasur qoftë Komisioneri, qoftë Komisioni, qoftë Prokuroria e Përgjithshme, ka rezultuar që zakonisht shtetas, po themi që kanë ndryshuar gjeneralitetet dhe kanë jetuar dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pa i paragjykuar kështu si *all in*, ka rezultuar që në raste të caktuara kan pasur probleme, po themi me dekriminalizimin. Kështu që ky ishte një, fakti që ky kandidat, pra shtetasi Elton Bano ka jetuar për 3 periudha të caktuara jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë. Ndërkohë kishte ndryshime në gjeneralitetet e tij që janë domethënëse. Ka 4 vite diferencë tek datëlindja dhe vendlindja e tij. Herë deklarohet në Lushnje, herë në Prishtinë, Kosovë, mendoj që është një rast, po themi që meriton dhe pak vëmendje më të veçantë. Për ata kandidatë të cilët edhe në një verifikim të parë, por të paktën sipas plotësimit të formularit nuk kanë deklaruar ndryshime të tilla të dhënash, sigurisht që mund të pritët po themi në një kohë më të gjatë përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Kështu që më lejoni, që në emër të subjektit zgjedhor që përfaqësoj në këtë komision, që mbase për rastin e zotit Bano, të kërkohet një informacion pak më i shpejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, duke qenë se është një rast për të cilin ne mendojmë se meriton vëmendje.

Z. I. Celibashi: Dakord! Kemi ndonjë informacion nga KZAZ-të?

Z. E. Metaj: Jo, vetëm KZAZ-ja 19 në Dibër ka sjellë 3 vendime për regjistrimin e 3 kandidatëve, dhe është në shqyrtim për një kandidat.

Z. I. Celibashi: Në rregull! KZAZ-të e tjera, jo?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.02.2022*

Z. E. Metaj: Jo!

Z. I. Celibashi: Por kemi kontakt që t'i shtyjme, që t'i sjellin mundësisht brenda ditës së sotme që ne të përfundojmë dhe procesin e shortit?

Z. E. Metaj: Kemi kërkuar prej tyre t'i sjellin sa më parë që të jetë e mundur dhe të marrim sa më shpejt vendimin. Nesër kanë thënë që do sjellin dokumentacionin. Kështu që besoj sot në darkë duhet ta përfundojnë.

Z. I. Celibashi: Ta parashikojmë që ta organizojmë procedurën e shortit nesër paradite. Kështu që do komunikuar sot me ta, nëse nuk kanë ndonjë pengesë të karakterit administrativ, se fitojmë një ditë pastaj dhe për fletët e votimit, edhe aspekte të tjera. Gjithsesi potencialisht nesër paradite ndoshta e zhvillojmë procedurën e shortit. Në rregull, mirë, nëse s'kemi gjë tjetër seanca mbyllet. Për kandidatin e LRE-së e shtymë për nesër. Faleminderit, natën e mirë!

Vendimi nr. 70

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

